



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:066477

Datë: 15.05.2019

Numri i dokumentit: 00313660

P. nr. 789/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës Sh. M. nga Gjakovë, për shkak të veprës penale heqje apo dëmtim i vulave zyrtare apo shenjave nga neni 414 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.1529/18 të datës 01.11.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **02.05.2019**, në prani të Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, pef. I autorizuar i të dëmtuarës A. D., mbrojtësit të akuzuarës av. P. K.si dhe të akuzuarës Sh. M., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **SH. M.**nga Gjakova, Rr” . . . “ nr. ,e bija e Q.Sh. dhe e nënës Gj. e gjinisë B. ,data e lindjes ... në fsh .S. K Pejë, ka të kryer shkollën fillore ,amvise , e gjendjes se dobët ekonomike- pension e pleqërisë se bashkëshortit , shqiptare ,shtetase e R. Kosovës ,e martuar ,nënë e 4 fëmijëve, me nr. ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

- me datë **09.10.2018, reth orës 17.50 min.**, në Rr” . . . ” në Gjakovë , Verifikim -AKKV dhe njoftimit se tani nuk mundet të banojë aty, ka shkuar dhe me pretekstin heqë ,dëmton vulën zyrtare përkatësisht shenjen e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qellim të sigurimit të objektit ,në atë mënyrë që pandehura pas dëbimit të bere nga zyrtarët e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe e marrjes se disa gjërave të mbetura që ka harruar nga dita e dëbimit , ka shkuar ka hequr dhe ka dëmtuar vulën zyrtare – shenjen e AKKV-së , ashtu që pas shkuarjes së policisë e njëjta është hasur ne shtëpinë që kishte blere O. M. nga Gjakova, me dt. 14.05.2018 përmes të autorizuarit A. K. nga Peja i angazhuar nga pronari i asaj shtëpie.

-me çka ka kryer veprën penale heqja apo dëmtim i vulave zyrtare ose shenjave nga neni 414 të KPRK-ës .

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,41,43,49,50,51,73, nenit 414 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarës i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet e akuzuara që ti paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga ana e gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej nga **20,00-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP.nr.1529/18 të datës 01.11.2018 kundër të akuzuarës Sh. M. nga Gjakova ,për shkak të veprës penale heqje apo dëmtim i vulave zyrtare apo shenjave nga neni 414 par.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 02.05.2019, Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj , lexojë aktakuzën PP.nr.1529/18 të datës 01.11.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, por të kualifikimi juridik i veprës penale për shkak të natyrës teknike duhet e hiqet paragrafi 1 i nënti 414 dhe të ngelte vetëm neni 414 .

E akuzuara Sh. M., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës së përmirësuar dhe të plotësuar me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qene se një gjë e tillë është konstatuar nga ana e të dëmtuarës ,mirëpo i vetmi qëllim i imi ka qene se të marr gjësendet e veta personale pasi që nuk e kam arritur të marr të gjitha me rastin e dëbimit që me është bere dhe nuk kam qene e vetëdijshme se heqja e shenjave me të cilat me është ndaluar hyrja është e kundërligjshme duke marr parasysh edhe nivelin e arsimimit tim ,andaj gjykatës i propozojë që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,gjendjen e dobët ekonomike- pendimin e shprehur në gjykatë për veprën e kryer dhe se një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe faktin se është hera e pare që kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarës av. P. K. deklaroi se e mbështet pranimin e fajësisë se bere nga ana e të akuzuarës pas konsultimit të mjaftueshëm dhe i propozoi gjykatës që të njëjtën ta aprovojë dhe të marr të gjitha rrethanat lehtësuese të parapara me ligj .

Perf. i autorizuar i të dëmtuarës deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës ,po ashtu deklaroi se është konstatuar se nga ana e ekipit kompetent të agjencisë se e njëjta është e gjendjes se dobët ekonomike dhe njëherë gjatë inspektimeve të pronës është konstatuar se e pandehura nuk e ka keqpërdor pronën por e ka shfrytëzuar për nevojat familjare .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që e njëjta është e vetëdijshme për pasojat dhe favorin juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova të mjaftueshme .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara Sh. M., - me datë 09.10.2018, rreth orës 17.50 min., në Rr” . .” në Gjakovë ,heqë ,dëmtim vulën zyrtare përkatësisht shenjen e ngjitur nga zyrtari i autorizuar me qëllim të sigurimit të objektit ,në atë mënyrë që pandehura pas dëbimit të bere nga zyrtarët e

Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim -AKKV , dhe njoftimit se tani nuk mundet te banojë aty, ka shkuar dhe me pretekstin e marrjes se disa gjerave te mbetura qe ka harruar nga dita e dëbimit , ka shkuar ka hequr dhe ka dëmtuar vulën zyrtare –shenjën e AKKV-së , ashtu qe pas shkuarjes së policisë e njëjta është hasur ne shtëpinë qe kishte blere O. M. nga Gjakova, me dt. 14.05.2018 përmes te autorizuarit A. K. nga Peja i angazhuar nga pronari i asaj shtëpie.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga e akuzuara e cila në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat , gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarës formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe e akuzuara të shpallet fajtores dhe ta gjykohej ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarës, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e te akuzuarës, është nënë e 4 fëmijëve , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, sjelljen korrekte në gjykim, pendimin e shprehur për veprën e kryer , premtimin se ne te ardhmen do te jem me e kujdesshme, gjendjen e dobët ekonomike –shfrytëzuese e pensionit te bashkëshortit si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin , të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarës ti shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje **prej 3(tre) muajve** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallen e përgjegjësisë së të akuzuarës dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasurore juridike me qene se perf. i autorizuar i te dëmtuarës nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 789/18 më datë 02.05.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin pre **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:066477
Datë: 15.05.2019
Numri i dokumentit: 00313660